

Vendim nr. 81 datë 18.04.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Marsida Xhaferllari,	Anëtare
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 18.04.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 7 (P) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **PRENG GEGAJ**, përfaqësuar nga avokat Ergys Gashi, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 6264, datë 18.06.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 506, datë 01.10.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2023-3713, datë 04.10.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, pika 2, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 71, 71/a dhe 71/b, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Holta Zaçaj, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Preng Gegaj ka pretenduar se bazuar në vërtetimin e pronësisë, datë 14.08.1997, është pronar i një pasurie të paluajtshme të përbërë nga një sipërfaqe trualli prej 1680 m², të ndodhur në Tiranë. Sipas kërkuesit, origjina e titullit të pronësisë buron nga kontrata e shitblerjes, datë 14.08.1997.

2. Me vendimin e datës 15.08.1997, Këshilli i Rregullimit të Territorit, Bashkia Tiranë, ka pajisur me leje ndërtimi shoqërinë “Ormars 2000” sh.p.k., për të ndërtuar një pallat 10-katësh, me sipërfaqe shfrytëzimi prej 401 m², mbi truallin në pronësi të trashëgimtarëve ligjorë të një subjekti të shpronësuar, të cilit i është njohur e drejta e pronës për këtë pasuri në vitin 1996 në bazë të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronës.

3. Kërkuesi, duke pretenduar se ndërtimi i kryer nga shoqëria e ndërtimit ka zënë një pjesë edhe të truallit në pronësi të tij, si dhe i ka shkaktuar humbje pasurore, në datën 02.12.2005 i është drejtuar me padi gjykatës. Ndërkohë, me prokurën e datës 17.05.2005 kërkuesi ka caktuar tre përfaqësues ligjorë për ta përfaqësuar atë në procedurat gjyqësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë e ndërtimit. Ai ka thirrur në gjykim, me cilësinë e personave të tretë, trashëgimtarët ligjorë të subjektit të shpronësuar, si dhe drejtorinë e urbanistikës në Bashkinë Tiranë.

4. Gjatë shqyrtimit të padisë në gjykatën e shkallës së parë, pasi çështja ishte kthyer dy herë për rigjykim nga gjykata e apelit, në seancën e datës 21.05.2012, dy nga përfaqësuesit ligjorë të kërkuesit kanë paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga përfaqësimi në gjykim. Për shkak të mungesës së përfaqësuesit tjetër ligjor, gjykata ka vendosur të shtyjë seancën për në datën 18.06.2012 dhe të kryejë njoftimin e tij. Me fletëthirrjen e datës 21.05.2012 gjykata ka dërguar njoftimin për datën, ditën dhe orën e seancës dhe sipas shënimit të pasqyruar në të, ajo është marrë në dorëzim nga një person i tretë.

5. Në vijim, në seancën e datës 18.06.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi ka konstatuar mungesën e përfaqësuesit ligjor të kërkuesit, me vendimin nr. 6264, datë 18.06.2012, ka vendosur pushimin e gjykimit. Sipas gjykatës, përfaqësuesi ligjor i kërkuesit ka marrë dijeni për datën dhe orën e seancës dhe në sekretarinë gjyqësore nuk është paraqitur ndonjë shkak ose arsye e ligjshme për mungesën në seancë, ndaj gjykata gjendej në kushtet e nenit 179 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

6. Mbi ankimin e kërkuetit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 506, datë 01.10.2013, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, me arsyetimin se kërkueti nuk ka paraqitur asnjë mjet justifikues për mospjesëmarrjen në seancë të përfaqësuesit të tij dhe se ai ka zgjedhur që gjykimi të bëhet vetëm në prani të avokatit. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkueti, i cili është regjistruar në datën 11.05.2015, ndërsa në datën 13.03.2023 përfaqësuesi ligjor i tij ka paraqitur parashtrime shtesë.

7. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2023-3713, datë 04.10.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së. Sipas Gjykatës së Lartë, nga ana e gjykatave të faktit janë respektuar dhe zbatuar drejt normat procedurale dhe dispozitat e ligjit material, si dhe standardet e procesit të rregullt ligjor, ndërsa pjesa e pretendimeve që ngre çështje të vlerësimit të provave del jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të asaj gjykate.

8. Në datën 16.02.2024 kërkueti i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual me objekt kundërshtimin e vendimeve të të tria gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për pushimin e gjykimit të padisë së tij, si të papajtueshme me Kushtetutën.

II

Pretendimet e kërkuetit

9. **Kërkueti**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga nenet 42, pika 2 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, në drejtim të:

9.1. *Së drejtës për gjykim të drejtë të lidhur me të drejtat e aksesit, njoftimit dhe marrjes pjesë në gjykim*, pasi përfaqësuesi ligjor i tij nuk ka marrë asnjë dijeni paraprake për seancën gjyqësore të datës 18.06.2012, duke bërë që gjykimi të jetë i padrejtë. Sipas tij, fletëthirrja e datës 21.05.2012 mban mangësi të rënda formale dhe substanciale, pasi është e paqartë dhe krijon pasiguri për personin që ka kryer njoftimin, i cili vetëm e ka nënshkruar atë pa pasqyruar identitetin e tij të plotë dhe në seksionin e marrësit, në datën 15.06.2012, ka nënshkruar, një person i cili nuk ka asnjë lidhje dhe asnjë njohje as me kërkuetin dhe as me përfaqësuesin ligjor të thirrur.

9.2. *Parimit të paanshmërisë*, pasi një nga anëtarët e trupit gjykues në Gjykatën e Lartë ka lidhje familjare me përfaqësuesen e personit të tretë, Bashkinë Tiranë

(bashkëshortë ndërmjet tyre), emri i së cilës pasqyrohet në disa procesverbale të seancave gjyqësore në shkallë të parë deri në datën 21.05.2012, si dhe në vendimin gjyqësor të datës 18.06.2012.

- 9.3. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi në pjesën arsyetuese nuk bëhet asnjë referim në shkaqet e rekursit të tij, përfshirë parregullsinë e rëndë të njoftimit në gjykimin në shkallë të parë dhe pranimin, në cilësinë e personit të tretë, të një personi që ka ndërruar jetë që në vitin 2007.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuarit

10. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vlerëson se kërkuari legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor objekt kundërshtimi, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se ky kriter përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuari dhe nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 31, datë 25.05.2015; nr. 15, datë 19.04.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Kolegji konstaton se kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, për rrjedhojë ai i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohet Gjykatës.

14. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastet e kundërshtimit të vendimeve gjyqësore, Gjykata e ka llogaritur afatin ligjor 4-mujor duke filluar nga data e shpalljes së vendimit nga gjykata që ka përfunduar procesin gjyqësor, pra nga organi gjyqësor që përbën mjetin e fundit ankimor, nëse kërkuesi nuk provon në nivel kushtetues se ka marrë dijëni në një datë të ndryshme. Ajo ka pohuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijëni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose me njoftimin elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin konkret, Kolegji vëren se vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 04.10.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 16.02.2024, pra pas 4 muajve e 12 ditëve. Kërkuesi ka parashtruar se vendimi i është komunikuar avokatit të tij në rrugë elektronike në datën 18.10.2023 (*shih paragrafin 16 të kërkesës*), duke i bashkëlidhur kërkesës *e-mail-in* e përcjellë nga Gjykata e Lartë. Në këto rrethana, Kolegji çmon se momenti kur kërkuesi ka marrë dijëni për vendimin e Gjykatës së Lartë konsiderohet data 18.10.2023, rrjedhimisht ankimi kushtetues individual i tij rezulton i paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, ndaj ai legjitimohet edhe *ratione temporis*.

16. Për sa i përket legjitimitit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, në drejtim të së drejtës për gjykim të drejtë të lidhur me të drejtat e aksesit, njoftimit dhe marrjes pjesë në gjykim, parimit të paanshmërisë, si dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të garantuara nga nenet 42, pika 2 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, të cilat *prima facie* hyjnë në juridiksionin e kësaj Gjykate, ndaj ato do të analizohen në vijim nga Kolegji.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për gjykim të drejtë të lidhur me të drejtat e aksesit, njoftimit dhe marrjes pjesë në gjykim

17. Kërkuesi ka pretenduar se përfaqësuesi ligjor i tij nuk ka marrë asnjë dijeni paraprake për seancën gjyqësore të datës 18.06.2012, duke bërë që gjykimi të jetë i padrejtë. Sipas tij, fletëthirrja e datës 21.05.2012 mban mangësi të rënda formale dhe substanciale, pasi është e paqartë dhe krijon pasiguri për personin që ka kryer njoftimin, i cili vetëm e ka nënshkruar atë pa pasqyruar identitetin e tij të plotë dhe në seksionin e marrësit, në datën 15.06.2012, ka nënshkruar një person i cili nuk ka asnjë lidhje dhe njohje as me kërkuesin dhe as me përfaqësuesin ligjor të thirrur. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar se pushimi i gjykimit përbën një pasojë reale, të prekshme, konkrete dhe negative ndaj tij, pasi e përjashton nga një gjykim i cili ka zgjatur afërsisht 7 vjet, duke zhvlerësuar një histori të tërë procedurale, ku ishin kryer shumë veprime dhe se ai me mundim dhe shpenzime të konsiderueshme kishte paraqitur shumë prova, ndërsa procesi ndodhej në fazën e dorëzimit të aktit të ekspertimit dhe afër përfundimit.

18. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

19. Gjykata ka theksuar se në kuadër të garantimit të një gjykimi të drejtë, e drejta për akses dhe për të marrë pjesë në gjykim, janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën. Në këtë këndvështrim, e drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës. Gjithashtu, ajo është e lidhur edhe me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit (*shih vendimet nr. 14, datë 21.03.2023; nr. 8, datë 23.02.2021; nr. 49, datë 22.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Kolegji vëren se kërkuesi në datën 17.05.2005 ka emëruar përfaqësues të tij ligjorë tre avokatë, të cilëve, ndër të tjera, u ka dhënë tagra të plota përfaqësimi përpara gjykatave. Në datën 02.12.2005, kërkuesi i është drejtuar me padi gjykatës së shkallës së parë dhe pas më shumë se 6 vjetëve që procesi gjyqësor kishte nisur dhe çështja ishte ende në gjykim në shkallë të parë, dy nga avokatët e kërkuesit, në seancën gjyqësore të datës 21.05.2012, kanë paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga përfaqësimi. Sipas tyre, kërkuesi nuk ka përmbushur detyrimet procedurale që lidhen me parapagimin e shpenzimeve të ekspertit, ndonëse ka pasur kontakte të vazhdueshme me përfaqësuesin ligjor të tij, por nuk është gjetur zgjidhja për këtë çështje.

21. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në seancën e datës 21.05.2012, ka vendosur të pranojë kërkesën për heqjen dorë të dy avokatëve dhe për t'i komunikuar një kopje të saj kërkuesit

dhe përfaqësuesit tjetër ligjor, ka shtyrë gjykimin për në datën 18.06.2012. Gjithashtu, ajo ka urdhëruar kryerjen e njoftimeve palëve në mungesë dhe ekspertit, si dhe personave të tretë në mungesë me shpallje. Me fletëthirrjen që mban datën 21.05.2012, gjykata ka njoftuar avokatin e tretë të kërkuarit që të paraqitet në datën 18.06.2012 për t'u dëgjuar si përfaqësues i tij, duke e bërë me dije se mosardhja shkakton pushimin e gjykimit, si dhe i ka bashkëlidhur kërkesën për heqjen dorë nga përfaqësimi të avokatëve të tjerë. Fletëthirrja mban të shënuar adresën e studios ligjore të avokatit të thirrur të ndodhur në Tiranë dhe shënimin me shkrim dore *“Marrë në dorëzim në datën 15.06.2018”*, nga një person që ka pasqyruar emër, mbiemër dhe e ka nënshkruar atë.

22. Në vijim, në seancën e datës 18.06.2012, gjykata, pasi ka konstatuar mungesën e të gjitha palëve, si dhe të personave të tretë të thirrur në proces, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes. Sipas procesverbalit të asaj seance, gjykata, për sa i takon mungesës së përfaqësuesit të kërkuarit, është shprehur se atij i është komunikuar kërkesa për heqjen dorë të avokatit tjetër dhe se nuk ka paraqitur ndonjë shkak të ligjshëm për mosmarrjen pjesë në seancë. Për pasojë, sipas gjykatës, mosparaqitja pa shkak të ligjshëm të përfaqësuesit të kërkuarit vlerësohet si heqje dorë, ndaj gjykimi i çështjes duhet pushuar.

23. Gjykata e Apelit Tiranë, në datën 01.10.2023, në seancë gjyqësore me praninë e vetë kërkuarit dhe të përfaqësueses ligjore të tij, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, si të drejtë dhe të bazuar në prova. Ajo gjykatë ka vlerësuar se kërkuari nuk ka provuar ekzistencën e rrethanave dhe fakteve të ngritura në ankim për të krijuar bindjen që vendimi duhet ndryshuar. Po kështu, Gjykata e Lartë në datën 04.10.2023 nuk e ka pranuar rekursin, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së. Sipas Gjykatës së Lartë, palëve iu është dhënë mundësia të realizojnë të drejtën e tyre të mbrojtjes, të paraqesin prova, të njihen me provat e palës kundërshtare, të debatojnë në lidhje me to, të shprehin qëndrimin e tyre për zgjidhjen e mosmarrëveshjes etj., duke u respektuar të gjitha parimet bazë të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor.

24. Në analizë të sa më sipër, Kolegji konstaton se kërkuari ka angazhuar për të mbrojtur interesat e tij tre përfaqësues ligjorë, të cilët kanë pasur tagra të plota përfaqësimi, por edhe përgjegjësinë për të përmbushur të gjitha detyrimet e rrjedhura për shkak të këtyre tagrave. Në kushtet kur të tre përfaqësuesit janë caktuar me të njëjtën prokurë të posaçme, prezumohet se ata kanë pasur dijeni për ndjekjen e procesit dhe hapat e ndërmarrë nga secili prej tyre për mbrojtjen e interesave të kërkuarit. Për më tepër, sikurse rezulton edhe nga përmbajtja e kërkesës për heqjen dorë, të tre avokatët dhe kërkuari kanë pasur kontakte të vazhdueshme ndërmjet tyre lidhur me

përmbushjen e detyrimeve dhe zgjidhjen e problematikave të hasura gjatë gjykimit. Në seancën gjyqësore kur është pranuar kërkesa për heqjen dorë, gjykata i ka lënë kohë në dispozicion përfaqësuesit tjetër për të marrë masat për të mbrojtur kërkuësin. Fletëthirrja e gjykatës mban të pasqyruar adresën e studios ligjore të avokatit dhe është marrë në dorëzim nga një person i identifikueshëm, ndaj të cilit nuk rezulton që kërkuësi ose përfaqësuesi i tij ligjor të kenë ndërmarrë ndonjë veprim ligjor, duke qenë se ka marrë në dorëzim një akt me rëndësi që nuk i takonte. Nga ana tjetër, gjykata e apelit ka zhvilluar gjykimin me praninë e palëve dhe ka konfirmuar se nga ana e përfaqësuesit ligjor nuk ka qenë e depozituar në sekretarinë e gjykatës së shkallës së parë, deri në datën 18.06.2012, ndonjë njoftim për shkakun e pamundësisë së marrjes pjesë në seancë.

25. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se gjykata ka kryer rregullisht njoftimin për datën dhe orën e seancën së planifikuar për datën 18.06.2012, ndaj pretendimi për cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë të lidhur me të drejtat e aksesit, njoftimit dhe marrjes pjesë në gjykim, është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të paanshmërisë

26. Kërkuësi ka pretenduar se një nga anëtarët e trupit gjykues në Gjykatën e Lartë ka lidhje familjare me përfaqësuesen e personit të tretë, Bashkinë Tiranë (bashkëshortë ndërmjet tyre), emri i së cilës pasqyrohet në disa procesverbale të seancave gjyqësore në shkallë të parë deri në datën 21.05.2012, si dhe në vendimin gjyqësor të datës 18.06.2012. Sipas tij, personat e tretë të thirrur në gjykim në çështjen e tij, përfshirë edhe Bashkinë Tiranë, kanë interesa të përbashkëta dhe secili prej tyre ka kërkuar rrëzimin e padisë.

27. Gjukata ka theksuar se parimi dhe e drejta për një gjykatë të paanshme nënkupton mungesën e paragjykimeve nga gjyqtarët në lidhje me çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njëres prej palëve. Në këtë kuptim, respektimi i parimit të paanshmërisë duhet të verifikohet duke aplikuar testin *subjektiv*, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes ose interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar dhe testin *objektiv*, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë. Në përcaktimin nëse një çështje konkrete ka arsye logjike për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që ankohen për diçka të tillë është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Në fakt, vendimtare është nëse objektiviteti i këtyre dyshimeve është mjaftueshmërisht i bazuar (*shih vendimin nr. 49, datë 16.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Kolegji vëren se kërkuesi në padinë e paraqitur në gjykimin në shkallë të parë, e cila mban datën 02.12.2005, ka përfshirë në cilësinë e personave të tretë Bashkinë Tiranë (Drejtoria e Urbanistikës Ligjore) dhe 6 (gjashtë) trashëgimtarët ligjorë të subjektit të shpronësuar. Gjatë gjykimit të padisë, Bashkia Tiranë është përfaqësuar me autorizim nga persona të ndryshëm, me detyrë juristë në drejtorinë juridike pranë këtij institucioni. Me autorizimin e datës 31.10.2011 është autorizuar juristja F.K. për ndjekjen e procesit gjyqësor, e cila nuk ka qenë e pranishme në seancën gjyqësore të datës 18.06.2012 kur është vendosur pushimi i gjykimit. Gjatë gjykimit në apel, Bashkia Tiranë, me autorizimin e datës 02.07.2013, ka caktuar një juriste tjetër për të ndjekur procesin, e cila e pyetur në seancën gjyqësore të datës 01.10.2013, kur ajo gjykatë ka disponuar me vendim, është shprehur se e lë atë në çmimin e gjykatës. Në Gjykatën e Lartë, relatori i çështjes për shqyrtimin e rekursit është caktuar me short A.K., që sipas kërkuetit është bashkëshorti i përfaqësueses së Bashkisë Tiranë, F.K.. Në përfundim, ajo gjykatë ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk kishte shkaqe ligjore.

29. Kolegji konstaton se përfaqësuesja F.K. ka qenë një nga juristet e Bashkisë Tiranë, e autorizuar nga institucioni me tagra përfaqësimi të interesave të atij institucioni, të cilin e ka përfaqësuar atë gjatë gjykimit në shkallë të parë. Në seancën gjyqësore, kur gjykata e shkallës së parë është shprehur me vendim për pushimin e gjykimit, përfaqësuesja F.K. nuk ka marrë pjesë. Ndërkohë që në gjykimin në apel, Bashkia Tiranë është përfaqësuar nga një juriste tjetër, e cila vendimmarrjen e ka lënë në çmimin e asaj gjykate. Gjithashtu, nuk rezulton që për shqyrtimin e rekursit në Gjykatën e Lartë, Bashkia Tiranë të këtë këtë paraqitur ndonjë akt (kundërrekurs ose parashtrime me shkrim) nga ndonjë përfaqësues i saj dhe që të jenë nënshkruar nga juristja F.K. Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë ka disponuar mospranimin e rekursit, pra ajo nuk ka bërë vlerësim në themel të çështjes.

30. Në këto rrethana, Kolegji, duke analizuar parimin e paanshmërisë nga këndvështrimi i testit *objektiv* dhe *subjektiv* të lidhur me thelbin e vendimmarrjes objekt kundërshtimi, pozitën dhe rolin e përfaqësueses së Bashkisë Tiranë në gjykim, çmon se nuk ekzistojnë fakte bindëse të cilat ngjallin dyshim legjitim për njëanshmërinë e gjyqtarit A.K. gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuetit për cenimin e parimit të paanshmërisë është haptazi i pabazuar.

Ç. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit gjyqësor

31. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë në pjesën arsyetuese të vendimit nuk ka referuar asnjë nga shkaqet e rekursit të tij, përfshirë parregullsinë e rëndë të njoftimit në gjykimin në shkallë të parë dhe gabimin procedural të gjykatës së apelit për pranimin në cilësinë e personit të tretë të një personi që ka ndërruar jetë që në vitin 2007. Sipas kërkuesit, gjykata e apelit ka çelur dhe zhvilluar disa seanca deri në shpalljen e vendimit, duke thirrur dhe njoftuar me shpallje një person që kishte ndërruar jetë në kohën e gjykimit të çështjes që në shkallë të parë në vitin 2007, për rrjedhojë për gjatë gjithë gjykimit atij i ka munguar zotësia juridike dhe procedurale.

32. Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, i cili ka funksion t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Po kështu, vendimet e mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar dhe se kjo mënyrë nuk cenon standardin kushtetues, kur në pjesën hyrëse listohen shkaqet e rekursit dhe përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e këtij vendimi nga kolegji (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt, në aspektin e shkeljes së të drejtave kushtetuese dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit. Gjatë shqyrtimit të pretendimeve për të drejtën për proces të rregullt ligjor nuk mjafton vetëm konstatimi i shkeljes procedurale, por duhet të analizohet karakteri i saj, pasojat që kanë ardhur për kërkuesin dhe për interesat që ai përfaqëson (*shih vendimin nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se personi që ka ndërruar jetë ka qenë një ndër personat e thirrur në gjykim si palë e tretë, si një nga trashëgimtarët ligjorë të ish-subjektit të shpronësuar. Në seancën gjyqësore të datës 17.01.2008 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka bërë zëvendësimin procedural të tij sipas dëshmisë së trashëgimisë të lëshuar me vendimin gjyqësor të datës 20.02.2007, me trashëgimtarët ligjorë (motra, vëllezërit dhe mbesat) të thirrur në atë gjykim, në cilësinë e personave të tretë. Pavarësisht kësaj, në vendimet objekt kundërshtimi nga kërkuesi, tek pala e tretë pasqyrohet dhe emri i këtij personi, krahas emrave të trashëgimtarëve ligjorë.

34. Për sa më lart, Kolegji çmon se ndonëse përfshirja e emrit të personit në tekstin e vendimit, për të cilin është vendosur zëvendësimi procedural, duket si mangësi, një konstatim i tillë nuk përbën shkelje thelbësore në procesin në fjalë, në kushtet kur gjykatat kanë marrë masa për zhvillimin e rregullt të gjykimit. Për më tepër, kërkuesi nuk ka argumentuar se si ky fakt ka lidhje të drejtpërdrejtë me interesat e tij dhe çfarë ndikimi ka sjellë mbi ecurinë e procesit gjyqësor.

Po kështu, megjithëse vendimi i Gjykatës së Lartë është me arsyetim të kufizuar, ai ka pasqyruar në mënyrë të plotë shkaqet e rekursit, rrethanat e çështjes dhe vlerësimin mbi këto shkaqe, duke i dhënë përgjigje thelbit të tyre, në përputhje me kompetencat ligjore të saj. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

35. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.